



Janar-Shtator 2022

Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm

Raport i punës Janar–Shtator/2022

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Cdojenje za Opštu Upravu

Nr. i prot. 4948 Më 24.10 2022
Br. prot. Dt.
RAHOVEC - ORAHOVAC

Erhan Morina

KOMUNA RAHOVEC



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Kuvendi Komunal Rahovec/Skupština Opštine Orahovac/Municipal Assembly Rahovec



Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm
Odeljenje za Privredu, Razvoj i Turizam
Department of Economy, Development and Tourism

DATE /A:	17.10.2022
PËR/ZA/TO :	z.Smajl Latifi, Kryetar i Komunës së Rahovecit
NGA/OD/FROM:	z.Erhan Morina, Drejtor për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm
LËNDA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Raport i punës për periudhën Janar-Shtator 2022



DREJTORIA PËR EKONOMI, ZHVILLIM DHE TURIZËM

Raporti është i bazuar në planifikimin, objektivat dhe detyrat e punës.

Fushëveprimtaria e Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm është e bazuar në aktet normative në fuqi dhe në planifikimin e punës për vitin 2022. Në kuadër të DEZHT, gjatë kësaj periudhe raportuese janë realizuar shumë aktivitete.


Aktivitetet e Drejtorisë;

Gjatë muajit janar, aktivitetet tona kanë qenë kryesisht të karakterit informues, ku janë vizituar projektet që janë realizuar nga Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, në vitin 2021 dhe projekte të tjera që janë në proces.

Në periudhë Janar-Prill, janë zhvilluar takime të ndryshme me institucione dhe ministri të ndryshme, me qëllim të rritjes së bashkëpunimit.

Janë mbajtur takime me Ministrinë e Zhvillimit Rajonal, Minsitrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregisë. Poashtu kemi mbajtur takime të ndryshme me Agjencinë e Zhvillimit Rajonal, si dhe takime të ndryshme me biznese që operojnë në komunën tonë.

Shih fotot 1.1 takim me biznese.



Takim pune në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT), ku është diskutuar financimi i zonës ekonomike në Opterushë.

Në mujain shkurt, së bashku me Kryetarin e komunës së Rahovecit, z. Smajl Latifi, kemi pritur në takim z. Fikrim Damka, Ministër i Zhvillimit Rajonal, ku është diskutuar rritja e bashkëpunimit në mes të MZHR-s dhe komunës së Rahovecit si dhe informimi rreth aplikimit për grante për vitin 2022.

Kemi marrë pjesë në panairin e punës në Suharekë me temën: Përgaditja e të rinjëve për tregun e punës, panair i organizuar nga AZHR. Në këtë panair kanë marrur pjesë 5 kandidat nga komuna e Rahovecit.

Në muajin mars, është publikuar lista e përfitueseve nga Organizata Help, ku 28 aplikant nga komuna e Rahovecit, të cilët kanë aplikuar për grante në vitin 2021, kanë nënshkruar kontratat me Organizatën

Gjermane Help. Në këtë memorandum bashkëpunimi në mes të K.K. Rahovec dhe Organizatës Gjermane Help, komuna e Rahovecit, ka financuar me 15000€.

Shih foton: 1.2 nënshkrimi i kontratave në mes të organizates Help dhe aplikantëve.



Në muajin Mars, kemi aplikuar për grante në MZHR. Në këtë thirrje, kemi aplikuar me projektin "Ndërtimi i Sheshit në Qendër të Qytetit".

Ky grant është fituar nga MZHR, dhe vlera e fituar e këtij granti është 75,000.00€

Vlera totale e kontraktuar e këtij projekti është 155,959.00€

Aktualisht projekti është në fazën e zhvillimit të punimeve dhe pritët që deri në fund të muajit nëntorë ky projekt të finalizohet..

Në këtë projekt parashihet të ndërrohen pllakat, ljerja e shtëpisë së kulturës "Mensur Zyberaj", mbjellja e drunjëve dekorativ, vendosja e ulsëve, ndriqim publik, si dhe fontana.

Shih foton: 1.3



Poashtu gjatë muajit mars, kemi marrë pjesë në sesionin informues të IPA-s, ku janë diskutuar thirrjet për grante të cilat do të jepen nga Bashkimi European.

Agjencia për Zhvillim Rajonal, në kordinim me Drejtorinë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, ka organizur sesion informues, lidhur me skemën e granteve që ka hapur MZHR, për bizneset.

1.0 Raporti i dëmeve nga vërshimet në Rahovec, shtator 2022

Komuna e Rahovecit më datë: 17 shtator 2022, është ballafaquar me vërshime të cilat u shkaktuan nga reshjet e shumëta të shiut, ku nga kjo poashtu u shkaktuan dëme të mëdha në amvisëri, ekonomi familjare she biznese.

Komisionet gjatë vizitave në teren konstatuan se dëmet janë të konsiderueshme. Ndër vendbanimet më të prekura janë fshatrat: Ratkoc, Fortesë, Krushë e Madhe, Dejnë, Celinë dhe Sopniq.

Komisioni ka filluar punën në teren nga data: 19.09.2022 deri me 30.09.202 dhe kanë arritur të vizitojnë 330 ekonomi familjare, amvisëri si dhe 10 biznese.

Vlera e dëmeve në ekonomi familjare dhe Aviseri të konstatuar nga tri komisionet është: 1,182,619.00€ Ndërsa vlera e dëmeve në biznese është: 77,285.01€ .

1.1 Investimet Kapitale


- Në periudhën janar-shtator 2022 DEZHT, është përqëndruar në modernizimin e tregjeve që funksionojnë në komunën tonë, duke finalizuar punimet në projektin "Ndërtimi i Tregut Ditor në fshatin Ratkoc". Në ceremoninë e përfundimit morën pjesë edhe zyrtarë nga MZHR. Ky projekt

ishte në bashkëfinancim me Ministrin e Zhvillimit Rajonal dhe vlera totale e këtij tregu të kontraktuar është 69,996.98€.

Shih fotot: 1.4 përrurim i tregut ditur në Ratkoc.



- Në projektin “Ndërtimi i Shtëpisë së të Moshuarëve” janë vendosur shtyllat elektrike, është nënshkruar marrëveshja me pronarin e “Restaurantit Bjeshka” për kyqje në trafo elektrike. Poashtu është bërë shpimi i një pusi në thellësi 200 metra, me qëllim të furnizimit me ujë të këtij projekti.
- Shih fotot: 1.5 shpimi i pusit në thellësi 200m.



1.2 Mirëmbajtja e shtigjeve të ecjes në komunën e Rahovecit dhe në fshatra

- Në kuadër të kontratës mirëmbajtja e shtigjeve të ecjes, është intervenur në rregullimin e shtegut të ecjes tek vendi i quajtur “Zhdrella”, i cili kishte pësuar dëmtime nga vërshimet dhe një herë tjetër është shaktuar shembje të gurve nga operatorët ekonomik që operojnë në atë zonë. DEZHT në bashkëpunim me drejtorinë për punë inspektuese kanë dalë në teren dhe kanë kërkuar nga kompania në fjalë që të sanojë dëmin e shkatuar dhe njëherit është kërkuar që të ndërmerren masa preventive që të pengohet shembja e gurëve.
- Poashtu te shtegu i ecjes në Krushë të Madhe, kompania Etniku, ka intervenuar në rehabilitimin e këtij shtegu pas shembjeve të dheut të shkaktuara nga kushtet atmosferike. Në këtë shteg, është bërë largimi i dheut dhe njëherit shtrimi i zhavorit.

Shih fotot:1.6 shtegu te Zhdrella.



- Në kuadër të projekteve investive, DEZHT ka zhvilluar procedurat e prokurimit për projektin: “Mirëmbajtja e shtigjeve në komunën e Rahovecit, në Dejn, Drenoc, në Gradish, dhe në Krushë të Madhe, si dhe më datë: 16.08.2022 është lidhur kontrata në vlerë 25,481.00€ Në këtë projekt parashihet mirëmbajtja e shtigjeve të ecjes në komunën e Rahovecit.
- Poashtu me 23.08.2022 është lidhur kontrata për projektin: “Rregullimi dhe rrethimi i Oborrit te depot e Matrexit” në Xërxë, ku vlera e nënshkruar e kontratës është: 22,968.00€. Ne këtë projekt janë duke u zhvilluar punimet dhe se ky projekt do të përfundojë në vitin 2022
- Ndërsa më 23.09.2022 është nënshkruar kontrata për projektin: “Ndërtimi, Restaurimi dhe Meremetimi i Shtëpisë së Verës në Rahovec”. Ky projekt do të përfundoj në vitin 2022.

1.3 Zyra për regjistrimin e Aseteve

- Punët dhe detyrat e punës janë kryer me përgjegjësi dhe profesionalizëm në harmoni me përcaktimin e detyrave të punës nga ana e menaxhmentit.

Regjistrimet e asetve janar-shtator 2022

Përshkrimi	Numri i Rgjistrimeve	Vlera në Euro
Regjistrimet mbi 1,000.00€-Investimet Kapitale	158	3,664,857.00€
Regjistrimet më pak se 1,000.00€	77	4,220,00€
Totali	235	3,669,077.00€

1.4 Zyra për Biznese

Gjatë periudhës raportuese Janar-Shtator, zyra për biznese ka kryer punë të ndryshme në shërbim të biznesve që operojnë në komunën e Rahovecit.

Evidenca e regjistrimit të bizneseve të Komunës së Rahovecit sipas bazës së programit online të ARBK mbahet në mënyrë të rregullt.

Tabela Nr 1

Nr.	Përshkrimi	Nr.
1	Biznese të regjistruara	101
2	Shuarje të njësisë	03
3	Historik të bizneseve nga ARBK	01
4	Biznese të shuara	26
5	Ndryshim në aktiviteteve dhe të ndryshme adrese, pronar dhe informata për biznese.	141
6	Vërtetime individuale	17
7	Çertifikatë N.U.I	107
8	Vërtetime biznesi	29
9	Konfirmim	01
10	Certifikat e dëmtuar	04
11	Ndryshim tipi biznesi	03
12.	Të ndryshme	34
	TOTAL	467

1.5 Sektori i taksave afariste

Gjatë periudhës janar-shtator, janë regjistruar të gjitha subjektet afariste prej librit kryesor të vitit 2021, në regjistrin e librit të vitit 2022, po ashtu në fillim të vitit 2022, është bërë kalkulimi i ngarkesave në forme elektronike, përpilimi dhe analizimi i ngarkesave të taksës afariste komunale për vitin 2022.

Në nëntemujorin e vitit 2022 janë përgaditur aktvendimet për të gjitha bizneset që janë të ngarkuara me taksë afariste komunale ku në bazë të kësaj ne kemi arritur të kemi një rritje të të hyrave .

Të hyrat nga taksat afariste.

Nr.	Përshkrimi	Vlera në €
1	Të hyrat në taksë afariste komunale, periudha janar-shtator 2022	79,403.90€

1.6 Sektori për Zhvillim Ekonomik

Evidenca e të hyrave dhe ngarkesës së qirasë të lokaleve afariste dhe pronës së paluajtshme të Komunës së Rahovecit, sipas bazës së shfrytëzimit si pasuri e paluajtshme komunale me të cilat disponon komuna e Rahovecit, mbahet në mënyrë të rregullt.

Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, aktualisht i menaxhon tridhjetë e gjashtë (36) kontrata, nga këto njëzetënjë (21) lokale afariste, dhjetë (10) objekte afariste dhe tre (3) hapësira të jashtme.

Poashtu në periudhën Janar-Shtator 2022, pëlqime të punës janë lëshuar gjithsejtë 26 (njëzet e gjashtë).

- Të hyrat nga qiraja për periudhën Janar-Shtator dhe saldoja është paraqitur në tabelën më poshtë:

Nr.	Përshkrimi	Vlera në €
1	Të hyrat nga qiraja për periudhën janar- shtator 2022	52,948.50€

1.7 Sektori i Turizmit

Zyra për Informacione Turistike, gjegjësisht Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, i ka zbatuar detyrat dhe obligimet e muajit janar-shtator, 2022 si në vijim:

Janë mbajtur takime me organizaten e UNDP-së në lidhje me projektin për programin Rajonal për Demokracinë Lokale në Ballkanin Perëndimor 2, ReLOad2, ku komuna e Rahovecit, është njëra nga komunat e përzgjedhura. Nga ky projekt në bashkëpunim me Reload2, u është mundësuar që 5 të rinjë të punësohen me pagesë në periudhë 6 mujore në insitucione të ndryshme private dhe shtetore.

Takim me SwissContact në Kosovë, Tema: implementimi i projektit "Nxitja e Punësimit dhe Mundësitë për zgjerim të punësimit" objektivi i të cilit është krijimi i vendeve të reja të punës dhe gjenerimi i të ardhurave në Kosovë, në sektorin e turizmit rural.

Pjesëmarrja në sesion informues në bashkëpunim me AZHR-në, Jug Prizren dhe zyren e projekteve në Rahovec, për grante të Ministrisë së Zhvillimit Rajonal, për biznese ekzistuese dhe për ndërmarrësit e rinjë (start-up);

Jemi në përpilimin të hartës turistike-digjitale, ku përmes sistemit CR Cod, do të bëhet mundur informimi për gjitha pikat turistike që gjinden në komunën tonë.

Poashtu në kuadër të turizmit, më datë: 02-03-04, shtator 2022 është organizuar festivali i vjeljes së rrushit "Hardh Fest".

Në këtë festival, morën pjesë turist nga Kosova, vëndet e rajonit dhe nga shtete të ndryshme të botës

Me respekt!